Paneli këshillëdhënës për të drejtat e njeriut
Building D, UNMIK HQ, Prishtinë/Kosovë | E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

VENDIM

Data e miratimit: 17 shtator 2014

Lënda nr. 38/10

Radmilla ARSIQ

kundër

UNMIK-ut

Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, më 17 shtator 2014,
me pjesëmarrjen e këtyre anëtarëve:

Marek Nowicki, kryesues
Christine Chinkin
Françoise Tulkens

Të ndihmuar nga

Andrey Antonov, zyrtar ekzekutiv

Pasi mori parasysh ankesën e lartpërmendur, e parashtruar në pajtim me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, të datës 23 mars 2006, mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut,

Pas shqyrtimit të vëmendshëm, duke përfshirë edhe shqyrtimin përmes mjeteve elektronike, në pajtim me rregullën 13 § 2 të Rregullores së punës, vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PARA PANELIT

1. Ankesa është paraqitur më 15 mars 2010 dhe është regjistruar më 30 mars 2010.

2. Më 30 janar 2012, Paneli kërkoi informata shtesë nga ankuesja. Më 31 janar 2012 dhe 2 shkurt 2012, Paneli pranoi përgjigjen e ankueses.

3. Më 26 maj 2014, Paneli e njoftoi për ankesën Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP), lidhur me dhënien e komenteve të UNMIK-ut mbi pranueshmërinë e ankesës. Më 18 qershor 2014, PSSP-ja dha përgjigjen e UNMIK-ut.

4. Më 3 korrik 2014, Paneli ia dërgoi ankueses komentet e UNMIK-ut dhe e ftoi atë që t'i ofrojë komentet e saj. Më 29 korrik 2014, Paneli pranoi përgjigjen e ankueses.

II. FAKTET

5. Ankuesja është ish-banore e Kosovës, e cila tani jeton në Serbi. Ajo, së bashku me djalin e saj, z. Bratisllav Arsiq, është bashkëpronare e një shtëpie në Prishtinë, ku ajo dhe familja e saj jetuan deri më 19 qershor 1999,kur ata duhej të largoheshin nga Kosova për shkaqe sigurie. Ankuesja pohon se ajo më vonë mori vesh se fqinji i saj. z. A.D. e kishte uzurpuar shtëpinë e saj. Ankuesja gjithashtu pohon se pas 17 marsit të vitit 2004, ajo mori vesh se shtëpia e saj ishte shkatërruar.

A. Procedurat gjyqësore civile para gjykatave kompetente në Prishtinë

6. Më 3 qershor 2004, ankuesja paraqiti një kërkesë për kompensim në Gjykatën Komunale në Prishtinë, kundër Komunës së Prishtinës, Institucioneve të Përkohshme për Vetëqeverisje të Kosovës (IPVQ), UNMIK-ut dhe KFOR-it, duke kërkuar kompensim për shkatërrim të pronës së saj. Ajo kërkon 345,000 euro si kompensim për këtë dëm.

7. Më 22 shkurt 2007, Gjykata Komunale e Prishtinës, duke u thirrur në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/10 të 16 tetorit të vitit 2006 mbi Zgjidhjen e Ankesave Lidhur me Pronën e Paluajtshme Private, duke përfshirë Pronën Bujqësore dhe Komerciale, konsideroi se Agjencia Kosovare e Pronës (AKP) ishte kompetente të vendosë për kërkesën e ankueses. Gjykata e shpalli veten pa juridiksion në kontest.

8. Ankuesja pranoi njoftimin për vendimin e Gjykatës Komunale, dhe më 27 korrik 2007, djali i ankueses, z. Bratisllav Arsiq, apeloi ndaj atij vendimi në Gjykatën e Qarkut të Prishtinës, si gjykatë e shkallës së dytë. Megjithatë, deri më 10 shtator 2014, ai nuk ka marrë vesh asgjë në lidhje me ankesën e tij.

9. Përafërsisht 17,000 kërkesa për kompensime janë paraqitur në vitin 2004 para gjykatave kosovare, pjesa më e madhe nga serbët etnikë, të cilët për shkak të armiqësive ishin larguar nga shtëpitë e tyre në Kosovë në vitin 1999 dhe prona e të cilëve ishte dëmtuar apo shkatërruar më vonë. Me qëllimin që të përmbushin limitin kohor prej pesë vjetësh të parashikuar me ligj për paraqitjen e kërkesave civile për kompensim, paraqitësit e kërkesave për kompensime dorëzuan kërkesat e tyre për kompensim përafërsisht në të njëjtën kohë në vitin 2004. Kërkesat për kompensim iu drejtuan kombinacionit UNMIK, KFOR, IPVQ dhe komunës përkatëse (shih Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut (PKDNJ), *Millogoriq dhe të tjerët*, lëndët nr. 38/08, 58/08, 61/08, 63/08 dhe 69/08, mendimi i 24 marsit të vitit 2010, § 1; për bazën ligjore në të cilën paraqitësit e kërkesave bazuan ankesat e tyre, shih mendimin e njëjtë, § 5).

10. Në lidhje me këto raste, më 26 gusht 2004, drejtori i Departamentit të Drejtësisë i UNMIK-ut (DD) u dërgoi një letër të gjithë kryetarëve të gjykatave komunale dhe të qarkut dhe kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës. Në letër, drejtori i DD-së përmendi se "mbi 14,000" kërkesa të tilla për kompensim janë paraqitur. Ai iu referua "problemeve që një valë e tillë e madhe do të paraqesë për gjykatat", dhe kërkoi që "asnjë rast [i tillë] të mos caktohet derisa të ketë një kohë të tillë ashtu siç ne së bashku e kemi përcaktuar për shqyrtimin më së miri të këtyre rasteve" (për tekstin e plotë të letrës, shih PKDNJ *Millogoriq dhe të tjerët*, i përmendur në § 9 më lart, në § 6).

11. Më 15 nëntor 2005, DD-ja u kërkoi gjykatave të fillojnë me shqyrtimin e kërkesave për kompensim për dëme të shkaktuara nga personat e zakonshëm të identifikuar dhe për dëmet e shkaktuara pas tetorit të vitit 2000, duke konsideruar se "pengesat për shqyrtimin efikas të këtyre rasteve" nuk ekzistonin më. Kërkesat për kompensim lidhur me ngjarjet që i takojnë periudhës para tetorit të vitit 2000, nuk u prekën nga kjo letër.

12. Më 28 shtator 2008, drejtori i DD-së këshilloi gjykatat se rastet që nuk janë caktuar për shqyrtim sipas kërkesës së 26 gushtit të vitit 2004 të shqyrtohen tani.

13. Më 9 dhjetor 2008, përgjegjësia e UNMIK-ut në lidhje me Policinë dhe drejtësinë në Kosovë përfundoi me Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë (EULEX), i cili mori kontrollin e plotë operacional në fushën e sundimit të ligjit, pasi që kryetari i Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara më 26 nëntor 2008 (S/PRST/2008/44), nxori Deklaratën që mirëpriste angazhimin e vazhdueshëm të Bashkimit Evropian në Kosovë.

B. Procedurat para Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore dhe UNMIK-ut

14. Më 11 dhjetor 2002, z. Arsiq paraqiti një kërkesë në Drejtorinë për Çështje Pronësore dhe Banesore (DÇPB) për riposedim të shtëpisë në Prishtinë.

15. Më 11 prill 2003, Komisioni për kërkesa pronësore dhe banesore (KKPB) lëshoi një vendim, të cilin z. Arsiq e pranoi më 23 janar 2004, që i jepte atij të drejtën për riposedim të pronës. Më 28 janar 2004, z. Arsiq kërkoi që DÇPB të administrojë pronën. Më 15 dhjetor 2005, DÇPB informoi z. Arsiq se prona e tij ishte shkatërruar, dhe si e tillë, ishte kategorizuar nga DÇPB si pronë që nuk mund të merrej nën administrimin e saj.

16. Në ndërkohë, përmes një letre të datës 12 korrik 2004, z. Arsiq i paraqiti një kërkesë PSSP-së, duke e informuar atë se prona e tij ishte shkatërruar pas trazirave të 17 marsit të vitit 2004 dhe kërkonte që"komuniteti ndërkombëtar të ndërtojë shtëpinë e njëjtë në vendin e njëjtë." Më 21 dhjetor 2004, UNMIK-u iu përgjigj z.Arsiq, duke e informuar atë se DÇPB konfirmon se prona e tij ishte shkatërruar dhe "[b]esohet, sidoqoftë se kjo ishte bërë para ngjarjeve të marsit, gjë që ju përjashton juve nga kompensimi nga programi i PSSP-së i krijuar për këtë qëllim … DÇPB do t'ju asistojë në riposedim të tokës tuaj me kërkesën tuaj."

17. Më 3 shkurt 2006, DÇPB kontaktoi z. Arsiq dhe e informoi atë se ata do të takoheshin me të në Beograd më 17 shkurt 2006 për t'i ndihmuar atij ta riposedojë pronën e tij. Megjithatë, më 7 shkurt 2006, DÇPB kontaktoi z. Arsiq dhe e informoi atë se takimi në Beograd ishte shtyrë për një kohë të pacaktuar. Më 29 qershor 2006, DÇPB i ofroi z. Arsiq riposedimin e pronës dhe KKPB ekzekutoi dëbimin e uzurpuesit të paligjshëm, z. A.D., i cili e kishte shfrytëzuar pronën e z. Arsiq. Përveç kësaj, kufijtë e pronës ishin vendosur me një shirit të DÇPB-së në bashkëpunim me kadastrën.

18. Më 23 janar 2007, z. Arsiq i dërgoi një letër DÇPB për të kërkuar informata mbi zbatimin e kërkesës së tij.Më 31 janar 2007, DÇPB i dha përgjigjen se prona e tij është konsideruar si e shkatërruar dhe se ai ishte informuar për këtë fakt më 9 shkurt 2006. DÇPB theksoi se urdhri i saj për dëbim ishte ekzekutuar më 29 qershor 2006, dhe se DÇPB nuk kishte juridiksion të mëtejmë në lidhje me këto çështje. Një çështje të tillë, ai u këshillua t'ia paraqesë Gjykatës Komunale ku është e vendosur prona.

C. Procedurat gjyqësore penale para Gjykatës Komunale në Prishtinë

19. Më 9 korrik 2009, ankuesja paraqiti një kallëzim penal në Zyrën e prokurorit publik komunal në Prishtinë kundër z. A.D. për "Zënie të paligjshme të pronës së paluajtshme". Më 17 dhjetor 2010, Zyra e prokurorit publik komunal regjistroi kallëzimin penal. Nuk shihet se është marrë ndonjë veprim tjetër lidhur me ankesën nga Gjykata Komunale e Prishtinës.

III. ANKESA

20. Ankuesja në esencë pohon se Gjykata Komunale e Prishtinës e shpalli veten pa juridiksion dhe se ankesa e saj kundër atij vendimi nuk ishte shqyrtuar nga Gjykata e Qarkut e Prishtinës. Rezultati është se ajo nuk kishte qenë në gjendje të marrë një vendim mbi bazueshmërinë e kërkesës së saj për kompensim për dëmet në pronën e shkatërruar. Në lidhje me këtë, konsiderohet se ajo mund të thirret në shkelje të së drejtës së saj për qasje në një gjykatë dhe të drejtës së saj për vendim gjyqësor për kontestin, e garantuar me nenin 6 § 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Ajo pohon se për arsyen e njëjtë është shkelur gjithashtu e drejta e saj për kompensim efektiv sipas nenit 13 të KEDNJ-së.

21. Ankuesja ankohet më tutje se nga shkatërrimi i pronës së saj dhe refuzimi i Gjykatës Komunale të Prishtinës që të vendosë për kërkesën e saj për kompensim të dëmeve, është shkelur e drejta e saj në pronë (neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së).

22. Për më tepër, ankuesja ankohet se nga dështimi i UNMIK-ut për ta përfshirë atë në programin e PSSP-së për kompensimin e pronarëve të pronës që është shkatërruar gjatë trazirave të 17 marsit të vitit 2004, është shkelur e drejta e saj në pronë (neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së).

23. Përveç kësaj, ankuesja ankohet rreth kohëzgjatjes së procedurave lidhur me ankesat e saj për pronën para DÇPB-së dhe rreth asaj se nuk ishte kompensuar nga DÇPB përmes administrimit të pronës së saj sipas skemës së qirasë. Në lidhje me këtë konsiderohet se ajo mund të thirret në shkelje të së drejtës për një vendim nga gjykata brenda kohës së arsyeshme, në kuptim të nenit 6 § 1 të KEDNJ-së dhe të drejtës së saj në pronë, e garantuar me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

24. Në fund, ankuesja ankohet se Gjykata Komunale e Prishtinës nuk ka vepruar në lidhje me kallëzimin e saj penal dhe si rezultat ajo nuk ka pasur një vendim të gjykatës brenda kohës së arsyeshme, në shkelje të nenit 6 § 1 të KEDNJ-së.

IV. LIGJI

25. Para se ta shqyrtojë bazueshmërinë e ankesës, Paneli duhet të vendosë nëse do ta pranojë ankesën, duke pasur parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në nenet 1, 2 dhe 3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12.

A. Procedurat gjyqësore civile para Gjykatës Komunale në Prishtinë

Shkelja e pretenduar e neneve 6 § 1 dhe 13 të KEDNJ-së

26. Paneli konsideron se, duke qenë se ankuesja thirret në shkelje të neneve 6 § 1 dhe 13 të KEDNJ-së, ajo në fakt ngrit dy ankesa (shih qasjen e miratuar, mes tjerash, në PKDNJ, *Millogoriq*, nr. 38/08, vendimi i 22 majit të vitit 2009; krahaso Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), *Açimoviq kundër Kroacisë*, nr. 48776/99, vendimi i 30 majit të vitit 2000; GJEDNJ, *Kutiq kundër Kroacisë*, nr. 48778/99, vendimi i 11 korrikut të vitit 2000). E para, ajo ankohet për faktin se për shkak të pezullimit të procedurave në Gjykatën Komunale të Prishtinës, ajo nuk ka qenë në gjendje të marrë ndonjë vendim për kërkesën e saj për kompensim të dëmeve për pronën e shkatërruar. Paneli konsideron se kjo ankesë mund të ngritë një çështje të së drejtës së saj për qasje në gjykatë sipas nenit 6 § 1 të KEDNJ-së dhe së drejtës së saj për kompensim efektiv sipas nenit 13 të KEDNJ-së.

27. E dyta, ankuesja ankohet rreth kohëzgjatjes së procedurave para Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe Gjykatës së Qarkut në Prishtinë. Këto procedura filluan më 3 qershor 2004, kur kërkesa e ankueses u dorëzua në Gjykatën Komunale. Procedurat ishin pezulluar më pas gjatë një kohe të caktuar. Më 22 shkurt 2007, Gjykata Komunale e paraqiti vendimin e vet, me të cilin e shpalli veten pa juridiksion. Ankuesja deklaron më tutje se ajo e paraqiti një ankesë kundër atij vendimi dhe se procedurat në lidhje me ankesën ende kanë mbetur pezull në Gjykatën e Qarkut.

28. Paneli konsideron se ankesat në lidhje me procedurat para Gjykatës Komunale në Prishtinë lidhur me nenet 6 § 1 dhe 13 të KEDNJ-së ngritin çështje serioze të fakteve dhe së drejtës, përcaktimi i të cilave duhet të varet në shqyrtimin e bazueshmërisë. Prandaj, Paneli konkludon që kjo ankesë nuk është qartë e pabazuar në kuptim të nenit 3.3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 (shih, mes tjerash, PKDNJ, *Millogoriq*, përmendur në § 26 më lart, në § 18).

29. Nuk është provuar asnjë bazë tjetër për ta shpallur këtë pjesë të ankesës të papranueshme.

Shkelja e pretenduar e nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së

30. Ankuesja ankohet rreth shkeljes të së drejtës së saj në pronë (Neni 1 i Protokollit nr. 1). Ajo përgjithësisht ankohet rreth faktit se prona e saj ishte dëmtuar gjatë gjysmës së dytë të vitit 1999 dhe rreth dështimit të gjykatës kompetente në Prishtinë që të vendosë për kërkesat e saj për kompensim.

31. Paneli rikujton se, sipas nenit 2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, ai ka juridiksion vetëm për "ankesat për shkelje të pretenduara të të drejtave të njeriut që kanë ndodhur jo më herët se 23 prill 2005, apo që rrjedhin nga faktet të cilat kanë ndodhur para kësaj date, ku këto fakte shkaktojnë një shkelje të vazhdueshme të të drejtave të njeriut". Dëmtimi dhe shkatërrimi i pronës janë akte të çastit, që nuk paraqesin një shkelje të vazhdueshme (shih PKDNJ, *Llajoviq*, nr. 09/08, vendimi i 16 korrikut të vitit 2008, § 7). Prandaj, kjo pjesë e ankesës është jashtë juridiksionit *ratione temporis* të Panelit.

32. Për sa i përket ankesës se, për shkak të pezullimit të procedurave të treguara nga ankuesja ata nuk kanë qenë në gjendje deri më tani të marrin kompensim për dëmin, Paneli thekson se, duke pasur parasysh se procedurat gjyqësore përmenden nga pikëpamja e së drejtës në pronë, këto procedura nuk mund të shkëputen nga aktet në të cilat bazohen kërkesat para gjykatave. Apo, për ta thënë konkretisht, ashtu si Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka bërë për sa i përket juridiksionit të vet sipas KEDNJ-së:

> "… Juridiksioni i përkohshëm i gjykatës përcaktohet në lidhje me faktet themelore të pengesës së pretenduar. Dështimi pasues për kompensim që ka për qëllim korrigjimin e kësaj pengese nuk mund ta sjellë atë nën juridiksionin e përkohshëm të Panelit" (GJEDNJ (Dhoma e Lartë), *Bleçiq kundër Kroacisë*, nr. 59532/00, vendimi i gjykatës i 8 marsit të vitit 2006, § 77, *KEDNJ*, 2006-III).

33. Prandaj, kjo pjesë e ankesës është jashtë juridiksionit *ratione temporis* të Panelit (shih, mes tjerash, PKDNJ, *Gojkoviq*, nr. 63/08, vendimi i 4 qershorit të vitit 2009, §§ 24-25).

B. Vendimi i UNMIK-ut për ta përjashtuar ankuesen nga Programi për kompensim i PSSP-së dhe procedurat para DÇPB-së

Shkelja e pretenduar e nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së

34. Ankuesja ankohet se UNMIK-u, duke mos e përfshirë atë në Programin e PSSP-së për kompensimin e pronarëve të pronës që është shkatërruar gjatë trazirave të 17 marsit të vitit 2004, e ka shkelur të drejtën e saj në pronë (neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së).

35. PSSP-ja paraqet kundërshtim për pranueshmërinë e kësaj pjese të ankesës, duke argumentuar se është jashtë juridiksionit *ratione temporis* të Panelit, pasi prona ishte shkatërruar para 23 prillit të vitit 2005, datën e fillimit të juridiksionit *ratione temporis* të Panelit. PSSP-ja thekson se "[ë]shtë e qartë nga dosja e rastit se DÇPB-ja ndërmori një hetim që mori kohë në përpjekje për të provuar faktet që ndërlidhen me shkatërrimin e pronës. Në atë kohë, është përfunduar se shkatërrimi i pronës ndodhi para trazirave të marsit të vitit 2004. UNMIK-u thotë se DÇPB-ja ishte në pozitën më të mirë në atë kohë për të arritur te ky përfundim."

36. Paneli konsideron se dëmtimi dhe shkatërrimi i pronës janë akte të çastit, që nuk paraqesin një shkelje të vazhdueshme (shih PKDNJ, *Llajoviq*, nr. 09/08, përmendur në § 31 më lart, në § 7; PKDNJ, *M.S. dhe të tjerët*, nr. 122/09 dhe të tjerët, vendimi i 5 prillit të vitit 2012, § 21). Data e saktë e dëmtimit të pretenduar të pronës së ankueses nuk është e njohur. Megjithatë, të dy ankuesja dhe PSSP-ja pajtohen se ndodhi më 17 marsit të vitit 2004 apo para kësaj date, (shih § 16 më lart) që është para datës së fillimit të juridiksionit *ratione temporis* të Panelit. Gjithashtu, data në të cilën UNMIK-u vendosi që mos ta përfshijë ankuesen në skemën e kompensimit të PSSP-së, 21 dhjetor 2004, është para datës së fillimit të juridiksionit *ratione temporis* të Panelit.

37. Prandaj, kjo pjesë e ankesës është jashtë juridiksionit *ratione temporis* të Panelit.

Shkeljet e pretenduara të nenit 6 § 1 të KEDNJ-së dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së

38. Ankuesja gjithashtu ankohet rreth kohëzgjatjes së procedurave lidhur me ankesat e saj për pronën para DÇPB dhe rreth asaj se nuk ishte kompensuar nga DÇPB-ja përmes administrimit të pronës së saj sipas skemës së qirasë. Paneli thekson se djali i ankueses dorëzoi ankesat e veta në DÇPB më 11 dhjetor 2002 dhe pranoi një përgjigje më 23 janar 2004, që i jepte atij të drejtën për riposedim të pronës (shih §§ 14-15 më lart).

39. Për sa u përket procedurave që u kryen para 23 prillit të vitit 2005, kjo pjesë e ankesës është jashtë juridiksionit *ratione temporis* të Panelit.

40. Për veprimet pasuese që ndodhën pasi që filloi juridiksioni i përkohshëm i Panelit më 23 prill 2005 në lidhje me pronën, Paneli thekson se më 15 dhjetor 2005, DÇPB-ja e informoi z. Arsiq se prona e tij ishte shkatërruar, dhe si e tillë, ishte kategorizuar nga DÇPB-ja si pronë që nuk mund të merret nën administrimin e saj. Pas kësaj, më 29 qershor 2006, DÇPB-ja i ofroi z. Arsiq riposedim të pronës, dhe KKPB ekzekutoi dëbimin e uzurpatorit të paligjshëm, z. A.D., i cili ishte duke e shfrytëzuar pronën e z. Arsiq. Më 23 janar 2007, z. Arsiq i dërgoi një letër DÇPB-së për të kërkuar informata mbi zbatimin e kërkesës së tij. Më 31 janar 2007, DÇPB-ja i dha përgjigjen se prona e tij është konsideruar si e shkatërruar dhe se ai ishte informuar në fillim për këtë fakt më 9 shkurt 2006 (shih §§ 17-18më lart). Paneli konsideron se DÇPB-ja veproi në rastin e kërkesës së z. Arsiq për riposedim në kohën e duhur. Paneli gjithashtu konsideron se DÇPB-ja nuk shkeli të drejtat në pronë të ankueses të dhëna asaj sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së duke gjetur se ajo pronë nuk ishte e banueshme dhe kështu nuk ishte e përshtatshme të administrohej sipas skemës së saj të qirasë. Prandaj, Paneli e hedh poshtë këtë pjesë të ankesës si qartë të pabazuar.

C. Procedurat gjyqësore penale para Gjykatës Komunale në Prishtinë

41. Ankuesja ankohet se Gjykata Komunale në Prishtinë nuk ka vepruar në lidhje me kallëzimin e saj penal dhe si rezultat ajo nuk ka pasur një vendim të gjykatës brenda një kohe të arsyeshme, në shkelje të nenit 6 § 1 të KEDNJ-së.

42. Paneli thekson se ankuesja deklaron se ajo paraqiti një kallëzim penal më 9 korrik 2009 dhe se Zyra e prokurorit publik komunal regjistroi kallëzimin penal. Paneli gjithashtu thekson se nuk shihet se është marrë ndonjë veprim tjetër lidhur me ankesën nga Gjykata Komunale e Prishtinës (shih § 19 më lart).

43. Për sa i përket kallëzimit penal të paraqitur pas 9 dhjetorit të vitit 2008, kjo pjesë e ankesës është jashtë juridiksionit *ratione personae* të Panelit (shih § 13 më lart).

PËR KËTO ARSYE,

Paneli, unanimisht,

- E SHPALL TË PRANUESHME ANKESËN PËR SA I PËRKET PAMUNDËSISË SË PRETENDUAR QË ANKUESJA TË MARRË NJË VENDIM TË GJYKATËS PËR KËRKESËN E SAJ PËR KOMPENSIM BRENDA NJË KOHE TË ARSYESHME (NENET 6 § 1 DHE 13 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT);

- E SHPALL TË PAPRANUESHME PJESËN TJETËR TË ANKESËS.

Andrey Antonov
Zyrtar ekzekutiv

Marek Nowicki
Kryesues